



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:284397
Datë: 29.05.2024
Numri i dokumentit: 05749289

C.A.P.nr.1124/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari individual Fatmir Baloku, në çështjen përmbarimore të kreditorit T.K Sh.A, me seli në Prishtinë me adresë në rr. "...", kundër debitorit H.L, me adresë në "...", KK Prishtinë, lidhur me çështjen përmbarimore për borxh, duke vendosur sipas ankesës së kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PPP.nr.6/20, të datës 28.02.2023, me datë 27.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditorit T.K Sh.A, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë PPP.nr.6/20, i datës 28.02.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar, PPP.nr.6/20, të datës 28.02.2023, ka vendosur: I. APROVOHET i bazuar propësimi i debitorit H.L nga Prishtina, ANULOHET Urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.791/18 i datës 23.08.2018, të lejuar nga përmbaruesi privat I.K në Prishtinë, si dhe refuzohet propozimi për përmbarim i paraqitur me datë 23.08.2018 nga kreditori T.K. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktvendimi kreditorja brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktvendimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Ka propozuar të aprovohet e themeltë ankesa e kreditores, të prishet aktvendimi i shkallës së parë dhe të lejohet urdhri përmbarimor.

Debitori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, nenit 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori në bazë të dokumentit të besueshëm faturës dhe kartelës së llogarisë për nr.tel..., cust.nr....., në vlerë prej 68.86 €, ka paraqitur propozim për përmbarim me datë 23.08.2018, ndaj debitorit për shumën e detyrimit në lartësi prej 68.86 euro.

Përmbartuesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit të datës 28.08.2018, ka nxjerrë Urdhrit Përmbartimor P.nr.791/18 i datës 23.08.2018, me të cilën e ka lejuar përmbartimin sipas faturës së ofruar, duke e pranuar si dokument të besueshëm, e cila i plotëson kushtet për ta lejuar përmbartimin.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim me datën 18.12.2019. duke propozuar që të: Aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri për caktimin e përmbartimit, ngase ka parashkrim.

Me përgjigje në prapësim të datës 30.12.2019, kreditorja ka kundërshtuar pretendimet e debitorit duke paraqitur se fatura i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm konform dispozitave të LPP-së. Po ashtu ka kundërshtuar pretendimin për parashkrim.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimin, me aktvendimin e atakuar ka vendosur që ta aprovoj si të bazuar prapësimin e debitorit, duke e shfuqizuar Urdhrit Përmbartimor, P.nr.791/18, i datës 23.08.2018, duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka arsyetuar se ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi është i bazuar. Gjykata ka vlerësuar me kujdes pretendimet e debitorit, duke e pranuar prapësimin, ngase fatura e bashkangjitur me nr. ..., e datës ..., në vlerë prej 68.86€, nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument përmbartimor – faturë kthyese, në kuptim të nenit 29 par.1.3 dhe 37 të Ligjit nr. 04/1-139 për procedurën përmbartimore. Sipas dispozitave në fjalë për përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm, është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori, debitori dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar. Ndërsa në rastin konkret, fatura që shërben bazë për propozim për përmbartim nuk rezulton t'i ketë përmbushur kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm. Fatura është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga kreditori të cilat nuk mund të jenë pa bazë ligjore për lëshimin e dokumentit autentik- faturës në procedurën përmbartimore. Të njëjtat nuk e përmbajnë nënshkrimin e pranuesit- debitorit, pra nuk është faturë kthyese.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika b), g), j), k), dhe m) të LPK-së dhe drejtë janë zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbartimore.

Pretendimi ankimor i kreditorit se aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përmbartimore pa specifikuar shkeljet e pretenduara, me arsyetimin se fatura në bazë të cilës është lejuar përmbartimi, është dokument i besueshëm dhe i përshtatshëm për përmbartim dhe se debitori të njëjtën e ka pranuar në mënyrë të rregullt, për Gjykatën e Apelit është pretendim i pabazuar, për shkak se me nenin 21 të LPP-së, përcaktohet se “*Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po që se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*”. Ndërsa në nenin 29 të LPP-së është përfshirë fatura si dokument i besueshëm. Në kuptim të këtyre dispozitave nënkuptojmë se organi përmbartues duhet të vendos brenda kufijve të titullit përmbartues, ndërsa me rastin e vendosjes për prapësimin e debitorit, gjykata është dashur të vlerësoj se a ekziston ndonjëri nga shkaqet ligjore të parapara me nenin 71 të LPP-së, dhe se arsyetimi i gjykatës si në arsyetimin e aktvendimit të atakuar në këtë fazë të procedurës, është i drejtë dhe i bazuar në dispozitat e LPP-së.

Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së, se me rastin e pranimit të prapësimin të palës debitore të paraqitur kundër Urdhrin mbi lejimin e përmbartimit,

P.nr.791/18, i datës 23.08.2018, sepse gjykata i ka vlerësuar rrethanat e lartcekura në kuadër të provave që i ka pasur në dispozicion në momentin e vendosjes sipas prapësimit.

Gjykata ka vlerësuar me kujdes pretendimet e kreditorit se fatura i plotëson kushtet për t'u cilësuar si dokument i besueshëm dhe të lejohet përmbartimi, mirëpo pas analizimit të saj, vërehet se fatura me nr. ...,e datës ..., në vlerë prej 68.86€, nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm – faturë kthyese, në kuptim të nenit 29 par.1.3 të Ligjit nr. 04/1-139 për procedurën përmbartimore. Sipas dispozitave në fjalë për përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm, është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori, debitori dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar. Ndërsa në rastin konkret, fatura që shërben bazë për propozim për përmbartim nuk rezulton t'i ketë përmbartur kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm. Fatura është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga kreditori, e njëjta nuk përmban nënshkrimin e pranuesit - debitorit, pra nuk është faturë kthyese. Po ashtu, kartela e bashkangjitur, nuk e ka të specifikuar periudhën kohore, dhe as propozimi për përmbartim.

Këto elemente si të tilla këtë dokument e bëjnë të papërshtatshëm për përmbartim dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore nga neni 29, paragrafi 3 të LPP-së “*dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar*”. Rrjedhimisht urdhri i lëshuar nga Përmbartuesi Privat është lejuar në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, andaj gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka aprovuar prapësimin e debitorit si të themeltë dhe se kjo gjykatë për arsyet e paraqitura si më lartë refuzoj pretendimet ankimore të kreditorit, ndërsa aktvendimin e atakuar vendosi ta vërtetoj.

Sipas nenit 43 par. 4 të LPP-së *Përmbartuesit privat nxjerrin urdhrin për përmbartueshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbartshin kushtet për përmbartueshmëri. Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbartueshmërisë së nxjerrë nga përmbartuesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbartimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbartuesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbartim nga përmbartuesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim.* Andaj, Gjykata e Apelit vlerësoi të ligjshëm mënyrën e vendosjes nga gjykata e shkallës së parë, se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e urdhrin për përmbartim nga përmbartuesi privat, sepse është lejuar përmbartimi në bazë të një fature, që i mungojnë cilësitë e duhura për t'u konsideruar si dokument i besueshëm.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
C.A.P.nr.1124/2023, me datë 27.05.2024

Gjyqtari
Fatmir Baloku d.v